REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT SHKODËR
KRYETARE

Nr. 481/1 Prot. **Shkodër, më 04.01.2023**

V E N D I M

Nr.18, Datë 28.12.2023

"Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2024, per Këshillin e Qarkut Shkodër"

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër , **"Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2024, për Këshillin e Qarkut Shkodër"**, Bazuar në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, Për sistemin e taksave Vendore", i ndryshuar, bazuar në nenin 5 pika 4,neni 38 pika ç, neni 77 germa f, neni 78, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 54,55 të ligjit nr.107/2014"Për planifikimin dhe Zhvillimin e territorit", Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" Ligjin nr. 97, datë 07.12.2023 "Per Buxhetin e Vitit 2024" Urdhërit nr.183, datë 26.05.2011 "Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga DAMT në qarqe", Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në proçesin e votimit ku u Miratua me **15** Vota **Pro**, **0** Vota **Kunder** dhe **0** Vota **Abstenim,**

V E N D O S I :

1-Të miratojë këto **Tarifa Shërbimesh** në Këshillin e Qarkut Shkodër, për shërbimet që do të kryhen ndaj të tretëve për vitin 2024, si më poshtë:

I	**Sektori i Planifikimit dhe zhvillimit territorial**	Tarifa (lekë)
1	Nxjerrje e dokumenteve arshivore (1 faqe A4)	**300**
2	Nxjerrje e dokumenteve arshivore (1 faqe A3)	**600**

3	Nxjerrje dokumente të konfirmuara për leje ndertimi (dosje komplete)	**5,000**
4	Konfirmim harta pronësie, viti 1962-1981.	**1,000**
5	Printim i hartave , format A 0	**4,000**
6	Printim i hartave , format A 1	**2,000**
7	Printim i hartave , format A 2	**1,000**
II	**Sektori i Sherbimeve Brendshme**	
1	Nxjerrje dokumente arshivore (1 faqe A4)	**500**
III	**DAMT**	
	Vertetim pronesie para vitit 1946	**1,000**
	Vertetim pronesie pas vitit 1946	**1,000**
	Vertetim negativ para reformës , për gjykatë	**500**
	Vertetim pronesie per ATP	**500**
	Vertetim pronësie per statusin të pastrehë	**200**
	Konfirmim Vertetetimi per ndihmë ekonomike	**100**
	Vertetim per kategorizim toke, sipas bonitetit	**1,000**
	Vertetetim per te dhena Formulari Nr.6	**500**
	Harta dhe skica planimetrike -kadastrale	**1,000**

2- Kuota e Antarësisë që Bashkite e qarkut Shkodër i financojnë Këshillit të Qarkut Shkoder për vitin 2024, do të miratohet dhe përfshihet në buxhetin e vitit 2024, pas miratimit të kësaj kuote në këshillat e bashkive respektive.

3-Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjitha Zyrat që ofrojnë keto shërbime .

4- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARE

Marina DUHANI